



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 500/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.07.2019 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt *Loti III ”Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Perendimore”*, me nr. REF-22402-05-16-2019, me fond limit 109,275,286 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 10.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Borshi” sh.p.k.  
Adresa: Lagjia “Bacallëk”, Rr. “Drini”, Shkodër.
- Autoriteti kontraktor:** Bashkia Shkodër  
Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, nr.1, Shkodër.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.05.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt *Loti III ”Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Perendimore”*, me nr. REF-22402-05-16-2019, me fond limit 109,275,286 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 10.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 23.05.2019, operatori ekonomik ankimues “Borshi” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit., me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Fondi limit i përcaktuar nga Bashkia Shkodër në masën 109 275 286 (Njeqind e nentemilion e dyqind e shtatedhjete e pesemije e dyqind e tetedhjete e gjashte ) lekë pa TVSH për 5 (pese) vite nuk përkon me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër me nr.85 datë 26.12.2017 “Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2018 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm perfundimtar 2018-2020 të Bashkisë Shkoder”.

Urdhëri i Prokurimit i nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë për këtë tender, duke u mbështetur në VKB nr.85 datë 26.12.2017, rezulton se ka angazhuar fonde publike për vitet 2021, 2022 dhe 2023 që janë të pamiratuara nga Këshilli Bashkiak dhe në këtë mënyrë është një veprim i kundraligjshëm dhe abuziv. Edhe pse në fakt data e publikimit është një datë më e vonshme se Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.82 datë 20.12.2018, sidoqoftë, referuar këtij vendimi të KB të Dhjetorit 2018, sërish AK nuk arrin të mbulojë me miratim, angazhimet me shpenzime deri në vitin 2021 dhe fondi limit i parashikuar për anagazhim për vitet 2022 e 2023 mbetet sërish i pamiratuuar për shpenzim nga Këshilli Bashkiak. Sa më sipër, është në kundërshtim me dispozitat ligjore e nënligjore si vijon:

Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e shqipërisë", në nenin 40 përcakton se: "Si rregull, e drejta për të kryer shpenzime, brenda kufirit të fondeve të miratuara, skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës. Për fondet e njësisve vendore, nga transferta e pakushtëzuar apo të ardhurat vendore, e drejta për të kryer shpenzime është në përputhje me përcaktimet e ligjit përkatës për vetëqeverisjen vendore. Ministri i Financave përcakton një sistem rregullash dhe procedurash për të kontrolluar që angazhimet shumëvjeçare të jenë brenda tavaneve trevjeçare, të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit. Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme të shpërndahen më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria e Financave që fondet, të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë direkt në sistemin informatik-financiar të Qeverisë, për ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe raportimin financiar regjistrojnë në këtë sistem angazhimin, brenda pesë ditëve pune nga data e nënshkrimit të tij, kundrejt urdhrin të prokurimit. Përcaktimi i limiteve trevjeçare të angazhimeve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme bëhet në përputhje me parimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik. Limiti i angazhimeve për njësitë e qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë vendore dhe regjistrohet në sistemin informatik financiar të Qeverisë."

Ligji nr.139/2015 "Për qeverisjen vendore", në nenin 40 pika 3 përcakton se: "3. Kryetari i bashkisë ose personat e autorizuar prej tij nuk lejohet të kryejnë shpenzime përtej shumës maksimale të shpenzimeve, të përcaktuar në zërin përkatës në buxhetin vjetor. Nuk lejohen shpenzime të fondeve nëse nuk ka fonde të mjaftueshme në gjendje në bashki për të mbështetur shpenzime të tilla. ";

Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenet 33 44.

VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, në nenin 76 pika 1 të të cilit parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron kontratat për një periudhë deri në mbylljen e vitit buxhetor, përveç rasteve kur lidhen kontrata shtesë, në përputhje me shkronjën "b", të pikave 3 e 5, të nenit 33 të LPP. Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë."

*Kryerja e procedurës së prokurimit në kushtet e pamjaftueshmërisë së mbulimit me fonde publike çënon në thelb:*

*(i) garancitë e realizimit të një shërbimi publik mjaft të rëndësishëm për qytetarët sic është menaxhimi i mbetjeve urbane, pra dëmton interesat e ligjshëm të shtetit dhe të shtetasve;*

*(ii) interesat e ligjshëm të personave juridikë pjesëmarrës në këtë garë, pasi jep informacion të pasigurtë e të pasaktë në lidhje me fondet e angazhuara dhe në këtë mënyrë i keqorienton ata në planifikimin e burimeve të tyre, financiare, njerëzore dhe makineri e pajisje për 5 vjet, ndërkohë që fondet e miratuara janë vetëm për 3 vjet;*

*Ne konkluzion: Kerkojme qe të rishikohet fondi limit dhe kohëzgjatja e kontratës në përputhje me fondet e miratuara nga Këshilli Bashkiak për tu angazhuar në shpenzime...*

*...AK, duke vëndosur në kërkesën për Leje Mjedisore të lëshuar nga QKL, fjalët specifike që duhet të përmbajë Leja Mjedisore si "(Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren)", jo vetëm nuk është në përputhje me objektin e prokurimit, por edhe ka dalë mbi çfarë parashikon kuadri ligjor në fuqi për lejet e mjedisit si vijon: Në "Specifikimet Teknike", vetë AK ka përcaktuar se: "Kompania private duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të prodhuara në zonën Perëndimore dhe të realizojë depozitimin e tyre në landfillin e Bushatit. Proces pune në vete jashtë kësaj metodologjie është dizefektimi i PGM , fshirja manuale, punonjës për mirëmbajtjen e plazhit si dhe puntor për mirëmbajtjen e tualeteve publike. "*

*Neni 34/5 i Ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit": "Deklarata mjedisore, leja mjedisore, leja e integruar mjedisore, autorizimi mjedisor dhe pëlqimi mjedisor, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë III.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Miratimi i tyre bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. "*

*Neni 33 i Ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit": "Menaxhimi i integruar i mbetjeve I. Menaxhimi i integruar i mbetjeve synon parandalimin ose reduktimin e mbetjeve dhe ndikimeve të dëmshme të tyre mbi mjedisin, si dhe përdorimin e efektshëm të burimeve natyrore, me qëllim mbrojtjen e mjedisit, të burimeve, të shëndetit të njeriut, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. 2. Masat për menaxhimin e mbetjeve përcaktohen me ligj të posaçëm."*

*Neni 68 i Ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit": "Licencimi i veprimtarive me ndikim në mjedis: Veprimtaritë me ndikim në mjedis, të përcaktuara në këtë ligj, licencohen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshihen në fushën III të shtojcës së tij. "*

*Neni 53 i Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve": "Personat fizikë a juridikë, që synojnë të kryejnë operacione për trajtimin e mbetjeve, pajisen me leje mjedisi në përputhje me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit".*

*Neni 4, pika 49 i Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve": "Trajtim" janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.*

*Neni 3, pika 8 i Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit": "Instalim" është çdo njësi teknike e palëvizshme, që kryen një ose shumë veprimtari, si dhe çdo lloj tjetër veprimtarie*

që lidhet drejtpërdrejt me të apo ka një lidhje teknike me veprimtarinë e zhvilluara në njësinë e mësipërme dhe që mund të ndikojë në shkarkimet dhe ndotjen;

Neni 4 i Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit": "Në përputhje me ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë: a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/A të këtij ligji; b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji; c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/C të këtij ligji."

VKM nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", Aneksi I "Kategoritë e licencave e lejeve që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet QKL-së, Fusha III "Mjedisi dhe burimet mjedisore bazë", Kategoria III.1 "Për ndikimin në mjedis": "1. Lejet mjedisore të përcaktuara në 34 pika 5 e ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar bëjnë pjesë në kategorinë III.1 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"11.2. Lejet e ndikimit në mjedis ndahen në tre nënkategori si vijon: a) "Leje e thjeshte mjedisore" me kodin III.1.A; b) "leje mjedisore" me kodin III.1.B; c) "leje e integruar mjedisore" me kodin III.1.C. "

Nga gjithë dispozitat e mësipërme konstatohet se: Objekti i prokurimit përmban: Grumbullim, transport, depozitim, trajtim i mbetjeve që përfshin në vetvete edhe shërbimet e fshirjes dhe lajres së rrugeve. Pra, leja mjedisore për këtë objekt që lëshohet nga QKL, është ajo me kodin III.1 (A, B, ose C) dhe përshkrimi në të i operacioneve të cilat mbulon është sipas emërtimeve të përcaktuara në Shtojcën 1 "Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi", të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, konkretisht ato të përcaktuara në këtë Shtojcë në pikën "Menaxhimi i mbetjeve", me nr. 5.1-5.11. Nga dispozitat ligjore të sipërcituara, në referim të Shtojcës 1 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, rezulton qartë, se cilat janë aktivitetet që pajisen me leje mjedisore (të tipit A, B, ose C) në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Në këtë kontekst, sipas Shtojcës I të sipërcituar, leja mjedisore sipas objektit të kontratës lëshohet për aktivitetet në pikat 5.3.(c), (d) ose (e) të Shtojcës 1 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, me kod III.1.B ose III.1.C.

Ne konkluzion: Kerkojme që pika 3.3.9 të bëhet: "Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me:

Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit sipas objektit të prokurimit me Kodin III.1.B ose III.1.C.

Licensë e lëshuar nga qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane kodi III.2.B...

...Kjo kërkesë si më sipër, është në kundërshtim me Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 92.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, ku është përcaktuar: " "Pas pikës 5, të kreut

*II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: “6. Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmanje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.”.*

*Duke u nisur nga sa më sipër, shihet qartë se kërkesa e vendosur nga AK ka karakter diskriminues dhe synon të krijojë pabarazi në trajtimin e konkurentëve. Përderisa ka një akt nënligjor, vendim të KM që ka përcaktuar se detyrimi i ndërmarrjeve për angazhim të mjekut të punës është në varësi të grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup, pra nuk mund të jetë ky detyrim i njëjlojtë për të gjithë operatorët ekonomikë. Gjithashtu edhe rregullat se si ndërmarrjet e marrin shërbimin e kujdesit shëndetësor, dhe mënyra e kontraktimit është në varësi të klasifikimit të operatorëve në grupe të ndryshme dhe numrit të punëmarrësve. AK nuk mund të vendosë kritere që dalin përmbi përcaktimet e Vendimeve të KM pasi tejkalon kompetencat e veta. [...]*

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues lidhur me ankesën.

II.4. Në datën 05.06.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Në datën 26.06.2019, nëpërmjet shkresës me nr.10743prot., datë 21.06.2019, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Borshi” sh.p.k.

II.6. Në datën 15.07.2019, me shkresën nr. 1010/4 prot., i është kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë informacion në lidhje me fondin e kësaj procedure prokurimi.

II.7. Në datën 29.07.2019, me shkresën nr. 13569/1 prot., datë 25.07.2019, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“Nga gjithë dispozitat e mësipërme konstatohet se: Objekti i prokurimit përmban: Grumbullim, transport, depozitim, trajtim i mbetjeve që përfshin në vetvete edhe shërbimet e fshirjes dhe lajres se rrugeve. Pra, leja mjedisore për këto objekt që lëshohet nga QKL, është ajo me kodin III.1 (A, B, ose C) dhe përshkrimi në të i operacioneve të cilat mbulon është sipas emërtimeve të përcaktuara në Shtojcën 1 "Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi", të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, konkretisht ato të përcaktuara në këtë Shtojcë në pikën "Menaxhimi i mbetjeve", me nr. 5.1-5.11. Nga dispozitat ligjore të sipërcituara, në referim të Shtojcës 1 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, rezulton qartë, se cilat janë aktivitetet që pajisen me leje mjedisore (të tipit A, B, ose C) në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Në këtë kontekst, sipas Shtojcës 1 të sipërcituar, leja mjedisore sipas objektit të kontratës lëshohen për aktivitetet në pikat 5.3.(c), (d) ose (e) të Shtojcës 1 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, me kod III.1.B ose III.1.C.*

*Ne konkluzion: Kerkojme që pika 3.3.9 të bëhet: "Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me:*

*Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit sipas objektit të prokurimit me Kodin III.1.B ose III.1.C.*

*Licensë e lëshuar nga qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane kodi III.2.B...” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën nr.8, pika 3.3.9 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*” 9.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;*

*•Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren), (Kodi III.1.A)*

*•Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)*

*•Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçensë profesionale të Shoqërisë e vlefshme për kategorinë NP-12 (punime të inxhinierise se mjedisit), sipas modelit të lëshuar nga MPPTT ose MTI”*

III.1.2.Në shtojcën “Specifikime teknike”, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

*•Kompania private duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të prodhuara në zonën Perëndimore dhe të realizojë depozitimin e tyre në landfillin e Bushatit.*

*•Është parashikuar që në zonën Perëndimore çdo ditë prodhohen respektivisht 7.4 ton mbetje/ditë, kjo për Njësitë administrative, ndërsa për Plazhin gjatë 100 ditëve prodhohen mesatarisht 18.25 ton mbetje /ditë.*

•Gjithashtu kompania duhet të kryejë edhe zëra të tjerë shërbimi të detajuara si më poshte sipas dhe preventivit të shërbimit.

#### 1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

a. Zbrazen e kontenierëve 1100 liter me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, si dhe koshat e mbeturinave të parqeve dhe rrugëve pedonale.

b. Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier.

c. Pastrim të sipërfaqes prej 30 m<sup>2</sup> rreth çdo pike grumbullimi.

d. Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur.

e. Klorifikimi i zonës së kazanëve, sipas normativave.

f. Larja e kazaneve sipas nje grafiku të miratuar.

g. Mirembajtje dhe zëvendesim i koshave sipas kërkeses.

h. Transportin e mbeturinave në landfill.

i. Mbledhja dhe transportimi i inerteve dhe mbetjeve të ndërtimit, një vit pas lidhjes së kontratës, me kosto vetjake.

j. Mbledhja dhe transportimi i mbetjeve të rënda dhe voluminoze, me kosto vetjake.

k. Mbledhja dhe transportimi i mbetjeve organike dhe atyre të kopshteve, një vit pas lidhjes së kontratës, me kosto vetjake”

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: “b. aftësia teknike: operatorët ekonomike vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.1.4. Në nenin 28 pika 5 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

”5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose. [...]”

III.1.5. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenet 1 dhe 2, parashikohet shprehimisht:

“Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”.



*Ky ligj përcakton:*

*a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;*

*b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”*

III.1.6. Në neni 4 “Sistemi i lejeve të mjedisit” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, parashikohet shprehimisht:

*“1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:*

*a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/A të këtij ligji;*

*b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji;*

*c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/C të këtij ligji.”*

III.1.7. Në shtojcën 1 “Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, përcaktohet:

*”Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. Nqs nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti **kufi** nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo ”*

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përpara i përketë rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Në rastin konkretë, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, si dhe specifikimeve teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, Komisioni gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me disponueshmërinë e licensës të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren (kodi III.1.A), është në përputhje, i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore si

të ligjit nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”. Komisioni gjykon se, pretendimi i ankimuesit se duhen kërkuar leje mjedisore III.1.B ose III.1.C, pasi leja mjedisore sipas objektit të kontratës lëshohen për aktivitetet në pikat 5.3.(c), (d) ose (e) të Shtojcës 1 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, nuk qëndron pasi në asnjë rast për shërbimin objekt prokurimi nuk kërkohet asgjesim i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim biologjik, asgjesim i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim fiziko – kimik apo asgjesimi i mbetjeve jo të rrezikshme me metoda të tjera, por kërkohet vetëm zbrazja e koshave, pastrimi i tyre, si dhe transportimi i mbeturinave në landfillin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “[...]Kjo kërkesë si më sipër, është në kundërshtim me Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 92.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” , pika 1, ku është përcaktuar: “ Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: “6. Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmanje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.” [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr.8, pika 3.3.4 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

”4.Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit ose kontrate shërbimi të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figuroje në listëpagesa per periudhen Janar 2019- Prill 2019. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet ta disponoje mjekun ne varësi të numrit të punonjësve (1-15) që ka marrë përsipër të ofrojë sipas aktmarrëveshjes”

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]”

III.2.3. Në Vendimin Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, Kapitulli II “Klasifikimi i punëdhënësve në grupe, për efekt të organizimit të punëmarrësve në shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin”, përcaktohet se: “1. Për efekt të organizimit të shërbimit të brendshëm për mbrojtjen dhe parandalimin, punëdhënësit janë

klasifikuar në katër grupe, si më poshtë vijon: 1.1 Grupi A përfshin punëdhënësit me më shumë se 1000 (një mijë) punëmarrës. Ky numër punëmarrësish reduktohet në: 1.1.1 500 (pesëqind) punëmarrës për ndërmarrjet e: a) industrisë së pastrimit dhe shpërndarjes së ujit; b) industrisë së transformimit të metaleve, mekanikës e precizionit dhe industrisë optike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industritë e referuara në nënndarjen 1.1.2, shkronjat “dh”, “e”, “ë” e “f”; c) industritë e tjera prodhuese, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industritë referuara në pikën 1.1.2, shkronja “g”. 1.1.2 250 (dyqind e pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet e: a) industrisë së prodhimit e të shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit, avullit dhe ujit të ngrohtë; b) industrisë së prodhimit dhe të përpunimit fillestar të metaleve; c) prodhimit industrial prej guri, çimentos, betonit, qeramikës, qelqit dhe të tjerët; ç) industrisë kimike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industritë e referuara në 1.1.3, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”; d) prodhimit industrial të fibrave artificiale dhe sintetike; dh) industrisë së fabrikimit të veprave në metale; e) industrisë së ndërtimit të makinerive dhe të pajisjeve mekanike; ë) industrisë së ndërtimit dhe të autopjesëve; f) industrisë së ndërtimit të pajisjeve të tjera të transportit; g) industrisë së drurit dhe mobilieve të drurit; gj) industrisë së ndërtimit dhe të punëve publike. 1.1.3. 50 (pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet: a) e industrisë bërthamore; b) me furrat koks; c) e përpunimit të naftës; ç) e industrisë së prodhimit të kimikateve bazë; d) e industrisë petro-kimike dhe karbokimike; dh) e industrisë së prodhimit të produkteve të tjera kimike, kryesisht për industri dhe bujqësi. 1.2 Grupi B përfshin punëdhënësit me punëmarrës: a) nga 251 deri në 1000 persona, të cilët nuk janë përfshirë në grupin A; b) nga 100 deri në 250 persona, të cilët nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.1 të këtij kreu; c) nga 50 deri në 200 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.2 të këtij kreu; ç) nga 20 deri në 50 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.3 të këtij kreu. 1.3 Grupi C përfshin punëdhënësit me më pak se 200 (dyqind) punëmarrës, të cilët nuk përfshihen në grupet A dhe B. 1.4 Grupi D përfshin punëdhënësit që punësojnë më pak se 20 (njëzet) punëmarrës”.

III.2.4. Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” , pika 1, pika 3, gërma” b “ dhe pika 4 gërma “b” është përcaktuar: 1. "Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: “6. Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.”. [...] 3. Në kreun IV, pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon: “7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme: b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili: b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune; b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit”. 4/b) Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje: “3. Vendimi nr.

692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, shfuqizohet. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi”.

III.2.5. Në Vendimin Nr. 639, datë 7.9.2016 “Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”, pika 1, gërma “ë”, përcaktohet se: “Mjeku i punës/sëmundjeve profesionale”, çdo mjek që gëzon të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, i cili ka një formim afatshkurtër ose afatgjatë në fushën e mjekësisë së punës/sëmundjeve profesionale, të ofruar nga institucionet publike ose private të licencuara në Republikën e Shqipërisë ose në institucione jashtë vendit të njohura nga strukturat përkatëse në Republikën e Shqipërisë”.

III.2.6. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor gjatë hartimit të kriterit të dokumentave të prokurimit objekt ankimi, duhet të ketë parasysh parashikimet e Vendimit Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër. Në rastin konkretë, referuar volumit të kontratës objekt prokurimi, si dhe numrit të punonjësve të nevojshëm për zbatimin e kësaj kontrate, sipas përcaktimeve të vetë autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, kërkesa për disponimin e mjekut, është një kërkues e ekzagjeruar dhe jo në përpjestim me volumin e kontratës. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet ta heqi këtë kriter kualifikues.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “[...]Fondi limit i përcaktuar nga Bashkia Shkodër në masën 109 275 286 (Njëqind e nentemilion e dyqind e shtatedhjetë e pesemije e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë ) lekë pa TVSH për 5 (pese) vite nuk përkon me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër me nr.85 datë 26.12.2017 “Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2018 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm perfundimtar 2018-2020 të Bashkisë Shkoder”. Urdhëri i Prokurimit i nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë për këtë tender, duke u mbështetur në VKB nr.85 datë 26.12.2017, rezulton se ka angazhuar fonde publike për vitet 2021, 2022 dhe 2023 që janë të pamiratuara nga Këshilli Bashkiak dhe në këtë mënyrë është një veprim i kundraligjshëm dhe abuziv. Edhe pse në fakt data e publikimit është një datë më e vonshme se Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.82 datë 20.12.2018, sidoqoftë, referuar këtij vendimi të KB të Dhjetorit 2018, sërish

*AK nuk arrin të mbulojë me miratim, angazhimet me shpenzime deri në vitin 2021 dhe fondi limit i parashikuar për anagazhim për vitet 2022 e 2023 mbetet sërish i pamiratuuar për shpenzim nga Këshilli Bashkiak [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në pikat 2.8 dhe 2.9, të seksionit 2, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

*” 2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër*

*1.Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës: Loti i III-te”Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Perendimore” me fondin limit prej 109 275 286 (Njëqind e nentemilion e dyqind e shtatedhjetë e pesemije e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) leke pa tvsh per 5 (pese) vite buxhetore e detajuar si me poshte:*

*Viti I (2019) - fondi limit prej: 21 855 057 (Njëzetmilion e dyqind e njëzet e katermije e dyqind e shtatedhjetë e tete) lekë pa TVSH*

*Viti II (2020) - fondi limit prej 21 855 057 (Njëzetmilion e dyqind e njëzet e katermije e dyqind e shtatedhjetë e tete) lekë pa TVSH*

*Viti III (2021) - fondi limit prej 21 855 057 (Njëzetmilion e dyqind e njëzet e katermije e dyqind e shtatedhjetë e tete) lekë pa TVSH*

*Viti IV (2022) - fondi limit prej 21 855 057 (Njëzetmilion e dyqind e njëzet e katermije e dyqind e shtatedhjetë e tete) lekë pa TVSH*

*Viti V (2023) - fondi limit prej 21 855 057 (Njëzetmilion e dyqind e njëzet e katermije e dyqind e shtatedhjetë e tete) lekë pa TVSH*

*2.Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është \_\_\_\_\_*

*3.Burimi i Financimit: Vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Shkoder me anë të VKB Nr.85,datë 26.12.2017 “Për Miratimin e Buxhetit te vitit 2018 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm perfundimtar 2018-2020 te Bashkise Shkoder”.*

*4.Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:” Loti i III-te”Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Perendimore”.*

*2. 9Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:*

*Kohëzgjatja 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë kalendarike x 5 (pese) vite nga data e lidhjes së kontratës.”*

III.3.2. Në nenin 1, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Qëllimi i këtij ligji është a) të rrisë efijcencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.3.3. Në nenin 60 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është parashikuar shprehimisht: *“Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë: - objektin e prokurimit; - fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër; - llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti); - emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.*

III.3.4. Nisur nga pretendimi i operatori ekonomik ankimues, KPP me shkresën nr. 1010/4 prot., datë 15.07.2019, i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke kërkuar informacion në lidhje me fondin e kësaj procedure prokurimi. Në datën 29.07.2019, me shkresën nr. 13569/1 prot., datë 25.07.2019, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në të cilën citohet se: *“[...]Bashkia Shkodër është paraqitur me datë 14.11.2018 në degën e thesarit Shkodër për të firmosur Urdhër Prokurimin nr. 912 datë 14.11.2018 me objekt “Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër” (të trajtuara në Urdhrin e Prokurimit bashkelidhur). Dega e thesarit Shkodër pas verifikimit të bërë, ka firmosur këtë urdher për vitin 2019-2020 në bazë të VKB nr. 85 datë 26.12.2017 “Për miratimin e buxhetit viti 2018” dhe Programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2018-2020 të Bashkisë Shkodër (sipas shënimit në urdhrin e prokurimit). Procedura online e Prokurimit nga Bashkia Shkodër ka nisur në janar 2019. Dega e thesarit konfirmon se për vitin 2021 disponon fonde në bazë të VKB 407, datë 10.01.2019, sipas detajimit të buxhetit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm të vitit 2019-2021. Dega e thesarit Shkodër nuk ka konfirmuar urdhrin e prokurimit nr. 912 datë 14.11.2018, për 5 (pesë) vite pasi buxhetet janë 3 (tre) vjeçare [...].*

III.3.5. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për përcaktimin e nevojave të tij për mallra, shërbime e pune, duke përcaktuar për secilën prej tyre sasi të përkatëse dhe të duhura sipas nevojave të tij, specifikimet teknike të tyre, preventivin me llojin e mallit/shërbimit/punës, pra duke përcaktuar zërat përkatës, e në vijim të tyre duke përcaktuar edhe fondin limit për një objekt të caktuar prokurimi. Pra, është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, si organi me interes të drejtëpërdrejtë për kryerjen e procedurës së prokurimit, si edhe organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike, të përcaktojë fondin limit të një procedure prokurimi, në përputhje me sasi të domosdoshme për plotësimin e nevojave të tij. Në lidhje me fondin limit, nga verifikimet e kryera, konstatohet se ky i fundit është përlllogaritur për një periudhë 5-vjeçare, fond ky i pamiruar për vitet 2022 dhe 2023 nga organet përkatëse. Pra, autoriteti kontraktor, ka bërë përlllogaritjen e fondit limit, duke u nisur nga përlllogaritjet dhe ndarjet e zërave dhe volumeve të punës, por bazuar në një buxhet të miratuar vetëm për 3 vite dhe jo 5 vite. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe atë sektorial lidhur me përlllogaritjen e fondit limit dhe afatin e zbatimit së kontratës, pasi nuk mund të prokurohet një fond i cili nuk disponohet nga autoriteti kontraktor në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, e për rrjedhojë për shkak të shkeljeve të konstatuara, procedura e

mësipërme e prokurimit duhet anuluar, në zbatim të nenit 64, pika 2 gërma “ç” dhe nenit 24 gërma “dh” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parshikon se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Borshi” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt *Loti III ”Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Perendimore”*, me nr. REF-22402-05-16-2019, me fond limit 109,275,286 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 10.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rishpalljen saj të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Borshi” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1011 Protokolli, Datë 05.06.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**